

20121714021

LIGJ
PËR HUAMARRJE TË REPUBLIKES SË MAQEDONISE TE BANKA
NDERKOMBETARE PËR RINDERTIM DHE ZHVILLIM-BANKA BOTERORE SIPAS
MARREVESHJES PËR HUA PËR HUAN E PARË PROGRAMORE PËR POLITIKA
ZHVILLIMORE PËR KONKURRENCË

Neni 1

Republika e Maqedonise merr hua te Banka Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Banka Boterore në shume prej 38 700 000 euro, të dedikuar për realizimin e Huas së pare programore për politika zhvillimore për konkurrence.

Neni 2

Kushtet dhe menyra e shfrytezimit të huas nga neni 1 i ketij ligji, percaktohen me Marreveshje për hua për Huan e pare programore për politika zhvillimore për konkurrence, që do të lidhet ndermjet Republikes së Maqedonise dhe Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore.

Në emer të Republikes së Maqedonise Marreveshjen për hua nga paragrafi 1 i ketij neni, do ta nenshkruaje ministri i Financave apo personi i autorizuar prej tij.

Neni 3

Afati i pageses së huas nga neni 1 i ketij ligji eshte 18 vjet, me grejs periudhe të perfshire prej pese vitesh.

Shkalla e kamates eshte EURIBOR gjashtemujor me shtrirje variabile.

Në ditën e terheqjes së mjeteve të huas, Republika e Maqedonise do t'i paguaje Bankes Nderkombetare për Rindertim dhe Zhvillim-Bankes Boterore provizion të njehershem në shume prej 0,25% nga shuma e huas.

Huaja do të paguhet në 26 keste gjysmevjetore, në çdo 1 shkurt dhe 1 gusht të vitit. Nga 1 shkurti 2018 deri më 1 shkurt 2030 do të paguhet 25 keste gjysmevjetore, secili në shume prej 3,85% nga shuma e huas, ndersa më 1 gusht 2030 do të paguhet kesti i fundit në shume prej 3,75% nga shuma e huas.

Neni 4

Shfrytezues i mjeteve të huas nga neni 1 i ketij ligji eshte Ministria e Financave.

Neni 5

Republika e Maqedonise huan nga neni 1 i ketij ligji do ta paguaje nga Buxheti i Republikes së Maqedonise.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikes së Maqedonise".